



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: [fshmn@uni-pr.edu](mailto:fshmn@uni-pr.edu) • [www.uni-pr.edu](http://www.uni-pr.edu)

FSHMN

Ref. nr. 2986

Prishtinë, Dt. 04.09.2024

RAPORT I VLERËSIMIT TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMES  
MASTER

FAKULTETI	FSHMN
Departamenti/ Programi	Biologji / Biologji
Projektpropozimi	"Dixhitalizimi i mostrave të herbariumit të bimëve të rralla dhe të rrezikuara të Kosovës / Digitalization of herbarium vouchers of rare and threatened plants of Kosovo"
Kandidati	Bardhë Selmani
Mentori	Prof. Dr. Fadil Millaku
Aprovimi i projekt propozimit në	Datë: 30.10.2023
Këshillin e Fakultetit	Vendimi nr.: 6411

**Vlerësimi i dorëshkrimit**

**Shënimet e përgjithshme**

Punimi i Masterit me titull Dixhitalizimi i mostrave të herbariumit të bimëve të rralla dhe të rrezikuara të Kosovës punuar nga kandidatja **Bardhë Selmani** ka 75 faqe tekst me rrallim normal. Në punim është 1 tabela dhe 10 figura. Janë cituar 23 burime të literaturës. Punimi ka abstrakt si dhe rezyme në gjuhën shqipe e angleze. Në pjesën shtesë paraqitet Lista e llojeve. Jetëshkrimi i kandidates është në fund të punimit.

Në punim janë kapitujt: **Hyrje, Shqyrtimi i literaturës, Qëllimi i hulumtimit, Metodologjia, Rezultatet, Diskutimi, Përfundimet, Rezyme, Summary, Referencat.** Shtojca dhe Jetëshkrimi janë në fund të punimit.

**Analiza e Punimit**

Në **Hyrje** të punimit përshkruhen-analizohen të dhëna përgjithshme për herbariumin në përgjithësi,

për florën e Kosovës dhe për herbariumin e Kosovës në veçanti.

Literatura është e kohës, ajo shqyrtohet në kapitullin “**Shqyrtimi i literaturës**”.

Në kapitullin “**Qëllimi i hulumtimit**” bëhet arsyetimi i punimit përfshirë sfidat edhe rëndësinë e tij.

**Metodologjia** përshkruhet duke përfshirë edhe detaje lidhur me çështjet delikate gjatë dixhitalizimit të mostrave bimore.

Në kapitullin “**Rezultatet**” paraqetiten rezultatet e punimit. Në detaje paraqiten mostrat e llojeve bimore të dixhitalizuara ndër vite nga territori i Republikës së Kosovës.

**Diskutimi dhe përfundimet** paraqesin realitetin e dokumentimit respektivisht paraqitjes së gjendjes së mostrave bimore të prezantuara nga flora vaskulare e Kosovës.

**Referencat** e cituara janë tregues i përcjelljes së zhvillimeve të kohës nga botanika, konkretisht nga flora vaskulare.

#### **Vlerësimi dhe propozimi**

Ky punimi i masterit i kandidatës **Bardhë Selmani** është hulumtim floristik. Rezultatet e punimit janë arritur pas një pune të gjatë në laborator lidhur me përgatitjen dhe dixhitalizimin e mostrave bimore gjatë vitit 2023-2024. Rezultate e prezantuara padyshim se janë me vlerë për dokumentimin e florës vaskulare të Republikës së Kosovës.

Në këtë rast, komisioni për vlerësimin e këtij dorëshkrimi ka vlerësim pozitiv për Punimin e masterit të kandidatës **Bardhë Selmani**, me titull “**Dixhitalizimi i mostrave të herbariumit të bimëve të rralla dhe të rrezikuara të Kosovës / Digitalization of herbarium vouchers of rare and threatened plants of Kosovo**”. Komisioni i propozon Këshillit Mësimor-Shkencor të Departamentit të Biologjisë si dhe Këshillit Mësimor-Shkencor të FSHMN-së që punimin në fjalë ta pranojë dhe të formoj Komisionin për mbrojtje publike të Punimit të Masterit me qëllim të arritjes së titullit: Master i Shkencave të Biologjisë (Programi: Biologji).

Prishtinë, 04.09.2024

Komisioni:

1. \_\_\_\_\_  
/ Prof. Dr. Elez Krasniqi – kryetar/
2. \_\_\_\_\_  
/ Prof. Dr. Fadil Millaku – anëtar (mentor)
3. \_\_\_\_\_  
/ Prof. Assoc. Dr. Bekim Gashi – anëtar/

P.S. Numri i faqeve shtohet sipas nevojës.